

Shtojca 2 :

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

Komisioni i Përherëshëm i Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit
Strategjik

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 04 datë 01/09/2025

Nr. _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim “ Për një shtesë në VKB nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025” për projektin “INCREMENTAL” dhe “HERALD”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe VKB nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025”, .

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti INCREMENTAL (Intangible Cultural Heritage and Local Development – Communities, Safeguard and Resilience) është pjesë e programit Interreg Europe, ku Bashkia Gjirokastër merr pjesë si partner zyrtar. Projekti ka për qëllim forcimin e politikave vendore për ruajtjen, mbrojtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe lidhjen e saj me turizmin, artin, kulturën, ekonominë dhe zhvillimin social. Përmes këtij projekti, Bashkia Gjirokastër do të përfitojë nga shkëmbimet ndërkombëtare, praktikat e mira dhe përfshirja e komunitetit lokal për të fuqizuar identitetin kulturor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit.

PROJEKTI "HERALD"

Projekti HERALD (Hermes Encourages and Reshapes the Arts' Longevity and Development) ka si qëllim forcimin dhe zhvillimin e sektorit të Arteve Skenike në zonën ndërkufitare Itali – Shqipëri – Mal i Zi.

Projekti HERALD do të adresojë një sfidë të përbashkët, të përfaqësuar nga fakti se, pavarësisht interesit gjithnjë në rritje për Artet Performuese dhe prodhimet artistike, të cilat formësojnë kulturën e një kombi, është e qartë se ky sektor ende karakterizohet nga një "strukturë e fragmentuar, e cila i pengon operatorët vendas kulturorë dhe krijues të zgjerojnë biznesin e tyre dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e produkteve të tyre kulturore të personalizuar.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet

PROJEKTI INCREMENTAL

Buxheti i projektit - Përshkrimi Narrativ

Bashkia Gjirokastrë është një nga partnerët përfitues të projektit, me një buxhet total prej **126,525 €**. Ky buxhet është ndarë në kategori të ndryshme shpenzimesh, në përputhje me objektivat e projektit dhe rolin e Bashkisë në aktivitetet që do të zhvillohen.

1. Kostot e Stafit (52,804 €)

Këto fonde mbulojnë shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe detyrimet e tjera të lidhura me personelin e angazhuar drejtpërdrejt në projekt. Përfshirja e stafit siguron një menaxhim të vazhdueshëm dhe një zbatim efektiv të aktiviteteve, duke garantuar që Bashkia të jetë plotësisht e angazhuar në të gjitha fazat e projektit.

2. Shpenzime për zyra dhe administrim (7,920 €)

Një pjesë e buxhetit është parashikuar për të mbuluar kostot administrative dhe logjistike të lidhura me projektin.

3. Udhëtime dhe akomodim (18,200 €)

Ky zë shpenzimesh mbështet mobilitetin e stafit të Bashkisë Gjirokastrë në kuadër të projektit. Shpenzimet përfshijnë kostot e udhëtimeve ndërkombëtare dhe vendore, akomodimin, si dhe dietat për personelin gjatë pjesëmarrjes në takime pune, seminare, punëtori dhe ngjarje të tjera që lidhen me projektin

4. Ekspertizë dhe shërbime të jashtme (47,601 €)

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është dedikuar për angazhimin e ekspertëve dhe shërbimeve të jashtme. Kjo përfshin konsulencën profesionale, asistencën teknike dhe shërbimet e specializuara që nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm

PROJEKTI "HERALD"

Buxheti i projektit - Përshkrimi Narrativ

- Bashkia Gjirokastrë është partner përfitues i projektit *HERALD*, me një buxhet total prej **36,607.00 €**.

1. workshop, seminare dhe konferenca (ëorkshop/seminar/and conferences) - 26,928.00
€

Bashkia Gjirokastrë ka organizuar 2 (dy) ëorkshop/ seminar/ dhe konferenca me buxhet dedikuar prej **13,464.00 € (për aktivitet)**, **26,928.00 €** në total.

Buxheti në fjalë është tashmë përdorur për organizimin e 2 (dy) aktiviteteve. Shpenzimet përfshinë:

- Akomodimin në hotel
- Bileta avioni
- Vakte ushqimore dreka/darka
- Pushime kafeje (Cofee Break)
- Materiale kancelarie (postera, fletëpalosje, roll-up, stilolapsa, etj)
- Sallë takimi (venue)

2. Plan veprimi (Action plan/Model/Methods (ApMM)) - 9,679.00 €

Bashkia Gjirokastrë ka zhvilluar Planin e veprimit (*Action Plan*) me buxhet dedikuar prej **9,679.00 €**.

Në këtë Plan Veprimi, Bashkia Gjirokastrë ka kontribuar duke përzgjedhur praktikat më të mira që Bashkia Gjirokastrë ndjek si institucion lidhur me aspektin artistik, kulturor, teatror. Ky Plan Veprimi është punuar duke përmbledhur të dhënat e nxjerra nga organizimet e ndërsjellta të të gjithë partnerëve të projektit *HERALD*.

3. Ndarja e Buxhetit në bazë të Bashkë - Financimit

- Fondet IPA III CBC¹ : **31,115.95 € (85%)**
- Kontributi i Bashkisë Gjirokastrë: **5,491.05 € (15%)**

Burimi i financimit

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “INCREMENTAL” në vlerën 1 182 018.69 ALL

Fondi në shumën 1 182 018.69 Lekë Lekë do të përdoret sipas buxhetit të miratuar të projektit si më poshtë:

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Kostot e Stafit” në vlerën 487 350 ALL

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Shpenzime për zyra dhe administrim” në vlerën 73 102.5 ALL

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Udhëtime dhe akomodim” në vlerën 102514.07 ALL

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Ekspertizë dhe shërbime të jashtme” në vlerën 538 143.57

Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P413XXX “HERALD” në vlerën 1 312 336.08 ALL

Fondi në shumën 1 312 336.08 Lekë Lekë do të përdoret sipas buxhetit të miratuar të projektit si më poshtë:

Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P413XXX workshop, seminare dhe konferenca (workshops/seminar/and conferences) në vlerën 1 312 336.08

Drejtoria / Sektori përgjegjës: Drejtoria e Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh:

Komisioni i Finances dhe Buxhetit dhe keshilli bashkiak bazuar mbi detyrimet ligjore qe e detyrojnë administratën të raportojë si dhe sa here qe keshilli e sheh të nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Gjithë shtresat dhe kategoritë shoqërore të komunitetit të bashkisë Gjirokastrë, forcimi i politikave vendore për ruajtjen, mbrojtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe lidhjen e saj me turizmin, artin, kulturën, ekonominë dhe zhvillimin social, identitar qëndrueshmërinë e produkteve të tyre kulturore të personalizuara në territorin e bashkisë Gjirokastrë

Komisioni i Përhershëm i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik, i mbledhur me datën 01/09 / 2025, shqyrtoi projekt vendimit Për një shtesë në VKB nr.86 datë 12.12.2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025” për projektin “INCREMENTAL” dhe “HERALD”

paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni e me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

- ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
- ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
- ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“
- ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

VIHARE LAPA
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë: 01/09/2025